



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.O.

Nr./No./№ 01-2607/21
Data/Data/Датум 26-10-2021
PRIZORITË - PRITITË - ПРИТРИТИ

**Ndërmarrja Publike Qendrore
Posta e Kosovës Sh.A.**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të PK Sh.A., në mbledhjen nr. 17/ 2021, të mbajtur më datën 25/10/ 2021, aprovoi këtë:

**RREGULLORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DHE TË KONSUMATORËVE NË
POSTËN E KOSOVËS SH.A.**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo Rregullore rregullon të drejtat, përgjegjësitë, parimet, masat ndëshkuese dhe veprimet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të konsumatorëve në PK Sh.A. Përmes kësaj Rregulloreje përcaktohen përgjegjësitë e NP "Posta e Kosovës" Sh.A., përgjegjëse për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumente publike, duke zbatuar Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**Neni 2
Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

- 1.1. E dhënë personale** - çdo informacion në lidhje me një person fizik ose juridik, i cili mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi;
- 1.2. Përpunim** - çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi;
- 1.3. Shkelje e të dhënave personale** - çdo shkelje e masave të sigurisë që sjell asgjësimin, humbjen, ndryshimin, deklarimin e paautorizuar, aksidental ose të paligjshëm ose qasjen në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara ndryshe;
- 1.4. Informata sekrete** - të gjitha informatat, në çfarëdo forme qofshin, lidhur me ndodhitë ose projektet e biznesit të kaluar, të tashëm ose të ardhshëm të PK Sh.A. ose të kontraktuesve dhe konsumatorëve tjerë, informatat e të cilëve PK Sh.A. i posedon me obligim të ruajtjes së sekretit, pa kurrfarë kufizimi, duke i përfshirë sekretet e punës, programet kompjuterike, planet e shërbimeve ose prodhimit, listën e konsumatorëve,

584

hulumtimet, zhvillimet, planet e biznesit, çmimet dhe policat e tarifës, informatat lidhur me operacionet e punës, sistemet, sigurimin, komercializmin, marketingun, raportet e bashkëpunimit, shërbimet ose prodhimet, të dhënat financiare, listën e furnitorëve vendorë apo të jashtëm dhe njohuritë e specializuara të çfarëdo lloji qofshin, të drejtat ose pronat lidhur me çfarëdo ideje, zbulimet, proceset, programet, shërbimet ose prodhimin e regjistruar, të shfrytëzuar, të zhvilluar, të testuar, të prodhuar, të marra parasysh nga ana e kompanive ose konsumatorëve të saj, pa marrë parasysh nëse kanë vlerë komerciale eksperimentale ose të patentuar.

Neni 3 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale nga Posta e Kosovës Sh.A. karshi kontraktuesve dhe konsumatorëve tanë lidhur me lidhjen dhe zbatimin e kontratave të shërbimeve dhe marrëveshjeve afariste të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit.
2. Kjo Rregullore gjithashtu zbatohet për ruajtjen e informatave dhe të dhënave personale konfidenciale konform dispozitave të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 4 Objekti dhe të dhënat personale

1. Kjo Rregullore rregullon të drejtat dhe obligimet e palëve, kontraktuesve dhe konsumatorëve të PK Sh.A. lidhur me lidhjen dhe zbatimin e kontratave të shërbimeve dhe marrëveshjeve afariste të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit.
2. Kjo Rregullore rregullon të drejtat dhe obligimet e palëve përkitazi me përpunimin e të dhënave personale.
3. Objekt i kësaj Rregulloreje është edhe mbrojtja e të dhënave personale për punëtorët e PK Sh.A. konform nenit 2 paragrafi 1.1.
4. Meqenëse PK Sh.A. do të jetë përpunues i të dhënave personale të kontraktuesve dhe konsumatorëve sipas kontratave të shërbimeve garanton dhe merr përsipër masat si në vijim:
 - 4.1. Gjatë proceseve të punës, PK Sh.A. mbledh dhe përpunon të dhënat personale të kontraktuesve dhe konsumatorëve të saj në përputhje me kërkesat e tyre të bazuara në dispozitat ligjore në fuqi;
 - 4.2. PK Sh.A. gjatë kryerjes së shërbimit sipas kontratës dhe shërbimeve për konsumatorë, ruan dhe ka qasje në të dhënat personale, të cilat merren nga kontraktuesit dhe konsumatorët që aplikojnë për kryerjen e shërbimeve postare dhe të IFJB-së, si dhe shërbimeve tjera nga fushëveprimtaria e PK Sh.A.
 - 4.3. PK Sh.A. i përpunon të dhënat personale në mbështetje të parimit të: ligjshmërisë, drejtësisë, transparencës, saktësisë, ruajtjes, konfidencialitetit dhe llogaridhënies.

Neni 5

Obligimet e përpunuesit të të dhënave personale

1. PK Sh.A. garanton se do të përpunojë vetëm të dhënat personale sipas udhëzimeve të parapara me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. PK Sh.A. garanton që do t'i trajtojë këto të dhëna personale dhe të dhënat tjera të marra si konfidenciale dhe do të sigurojë që qasja në këto të dhëna të jetë e limituar vetëm për personat e autorizuar, të domosdoshëm, të thirrur për realizimin e marrëdhënieve kontraktuale.
3. PK Sh.A. garanton se nuk do të shpalosë asnjë të dhënë personale tek palët e treta në asnjë situatë, përveç në rastet kur ajo shpalosje është e kërkuar nga organet kompetente bazuar në dispozitat e ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. PK Sh.A. garanton se në vazhdimësi do të ushtrojë siguri të mjaftueshme si teknike, ashtu edhe organizative në ruajtjen e të dhënave personale sipas kërkesave të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të punëtorëve, kontraktuesve dhe konsumatorëve në përgjithësi.
5. PK Sh.A. gjatë procesit të përpunimit të të dhënave të subjekteve, i proceson ato në sistemet e veta të evidentimit duke zbatuar masat e përshtatshme teknike dhe organizative, të cilat garantojnë mbrojtjen e të dhënave.
6. Duke marrë parasysh gjendjen e teknikës, shpenzimet e zbatimit dhe natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe rrezikun e mundësisë së ndryshimit dhe ashpërsinë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë dhe juridik, kontrolluesi dhe përpunuesi zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm për rrezikun, duke përfshirë, ndër të tjera, sipas rastit:
 - 6.1 Pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale;
 - 6.2 Aftësinë për të siguruar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në vazhdim të sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit;
 - 6.3 Aftësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe qasjen në të dhënat personale në kohën e duhur, në rastin e një incidenti fizik ose teknik;
 - 6.4 Një proces të testimit, vlerësimit të rregullt të efektivitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit.
7. PK Sh.A. ndërmerr hapa për të garantuar që çdo person fizik/juridik që vepron nën autoritetin e kontrolluesit ose të përpunuesit, i cili ka qasje në të dhënat personale, nuk i përpunon ato, përveç sipas udhëzimeve nga kontrolluesi apo kur i kërkohet ta bëjë këtë nga ndonjë ligj specifik.

Neni 6
Dispozitat ndëshkuese

1. Ndaj të punësuarve të PK Sh.A., të cilët shkelin dispozitat e kësaj Rregulloreje, do të ndërmerren masa adekuate konform dispozitave të ligjit në fuqi dhe akteve interne të ndërmarrjes “Posta e Kosovës” Sh.A.

Neni 7
Dispozita kalimtare

1. Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj Rregulloreje është në kundërshtim me ligjet pozitive në Republikën e Kosovës, ajo dispozitë do të konsiderohet nul dhe pa efekt. Dispozitat tjera të Rregullores do të përdoren dhe interpretohen për rregullimin e materies nga objekti i Rregullores, në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi.
2. Çdo çështje e pa trajtuar nga kjo Rregullore që bie nën domenin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialitetit, do të rregullohet konform dispozitave të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 8
Dispozitat përfundimtare

1. Me këtë Rregullore do të njoftohen të gjithë punëtorët dhe personat përgjegjës, të cilët kanë të bëjnë me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve, kontraktuesve dhe të konsumatorëve të PK Sh.A.
2. Rregullorja në kopje elektronike të publikohet në ueb-faqen interne të NPQ “PK” Sh.A. për qasje të lirë të të punësuarve, kontraktuesve dhe të konsumatorëve të PK Sh.A.

Neni 9
Zbatimi

Kjo Rregullore hyn në fuqi datën e miratimit nga ana e Bordit të Drejtorëve, prej së cilës datë edhe fillon zbatimi i saj.

Safija Beseni



Kryesuese e Bordit të Përkohshëm-Drejtorëve
të NPQ “Posta e Kosovës” Sh.A.

